



Parku Industrial Mitrovicë,
Republika e Kosovës, Mitrovicë, 40000

Në mbështetje të nenit 3 paragrafit 1, nën-paragrafit 1.4 të Ligjit Nr. 05/L-120 për Trepçën (GZ/ Nr. 36 / 31 tetor 2016), të nenit 23 paragrafi 4, të Statutit të Trepça Sh.A, të nenit 17 dhe 21 paragrafët 1, 3 dhe 4, dhe neni 25 paragrafi 2, pika "h" të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, (G Z / Nr. 31/15 qershor), Komiteti i Auditimit i Bordit Mbikëqyrës të Trepça Sh.A pas përfundimit të procesit të intervistimit me gojë të kandidatëve më datë 15.07.2019, merr këtë:

VENDIM

- I. Me të cilin, në pozitën e Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm të Trepça Sh.A përzgjidhet z. Kujtim Saraqi;
- II. Mandati i kandidatit nga pika I, fillon nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi;
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Komiteti i Auditimit i Bordit Mbikëqyrës të Trepça Sh.A pas vlerësimit të dokumenteve të kandidatëve të paraqitur, dhe pas fazës së intervistimit për kandidatët të cilët janë thirrur në listën e ngushtë, duke u bazuar në kriteret ligjore të bëra publike edhe me konkursin e datës 06.06.2019 për Zyrtar të Auditimit të Brendshëm të Trepça Sh.A, në bazë të vlerësimit të të gjitha komponentëve dhe me qëllim të zbatimit të parimit të meritokracisë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryesuesi i Komitetit të Auditimit:

Esat Peci

Ky Vendim i dorëzohet:

- a) Të përmendurit;
- b) Anëtarëve të Komitetit të Auditimit;
- c) Anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës;
- d) Sekretarit të Trepça Sh.A;
- e) Arkivit të Trepça Sh.A.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi lejohet ankesa, në afat prej 8 ditësh, nga dita e publikimit të vendimit.